



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1186 / prot.

Tiranë, më 28 . 8 .2024

V E N D I M
Nr. 33 , datë 28.8.2024

P Ë R
PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË DHE NDIHMËS
LIGJORË QË NDOQËN PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR
PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe pas miratimit të listës së kandidatëve për magjistratë, ndihmës ligjorë që pranohen në Shkollën e Magjistraturës në Programin e Formimit Fillestar nëntëmujor, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 248, 266 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe të nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimeve nr. 469 dhe nr. 470, datë 31.7.2024 të KLGJ-së, si dhe të rregullores së brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, më datë 28.8.2024,

V E N D O S I:

1. Të publikohet lista e kandidatëve për magjistratë dhe ndihmës ligjorë që kanë ndjekur Programin e Formimit Fillestar 2023-2024 dhe kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas listës bashkëngjitur pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!